



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VII
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-028
Prishtinë, më 9 nëntor 2020, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 9 NËNTOR 2020

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Kuvendit, Arbërie Nagavci, Memli Krasniqi dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Arben Gashi, Teuta Haxhiu dhe Rasim Demiri.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetares së Kuvendit: Faton Peci dhe Artan Murati.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Musli Krasniqi dhe Shefki Shoshaj.

Nga: KDI-ja: Agnesa Haxhiu.

Mbledhjen e drejtoi kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani-Sadriu.

Kryesia, me propozimin e kryetares, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme,
3. Përgatitjet për seancë të re plenare,
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave.

* * *

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme të Kryesisë së Kuvendit

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit, të mbajtura më 13, 16 dhe 26 tetor 2020.

2. Pikat e papërfunduara nga seancat e mëparshme

Kryesia, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi i Republikës së Kosovës, të mërkurën, më 11 nëntor 2020, në orën 12:00, të mbajë vazhdimin e seancave, me këtë:

Rend dite

I. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 16, 21 dhe 29 tetor 2020:

1. Votimi i Projektligjit nr. 07/L-025 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me financimin e programit - nxitja dhe levimi i mundësive për sigurimin e ujit,
2. Votimi i Projektligjit nr. 07/L-035 për ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë për likuiditet të urgjencës së infrastrukturës vitale, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim,
3. Votimi i Projektligjit nr. 07/L-036 për ratifikimin e Kontratës Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për Projektin e Impiantit të Ujërave të Zeza në Gjilan,
4. Votimi në parim i Projektligjit nr. 07/L-037 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë,
5. Votimi në parim i Projekt-Kodit Civil të Republikës së Kosovës nr. 07/L-019.

II. Pikat e papërfunduara nga seancat plenare, të mbajtura më 7, 13, 14 gusht dhe 17, 18, 21, 25, 28 shtator, 8, 16 dhe 29 tetor 2020:

1. Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së.
2. Votimi i propozim-rezolutës nga raportimi i kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, në lidhje me dialogun Kosovë - Serbi,
3. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca e ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, z. Agim Veliu, sipas kërkesës së deputetes Fatmire Kollçaku, e nënshkruar edhe nga 9 deputetë tjerë nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, në lidhje me hyrjen dhe patrullimin e pjesëtarëve të uniformuar të Republikës së Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës, përkatësisht në fshatin Karaçevë të Komunës së Kamenicës,
4. Votimi në parim i Projektligjit për masat e përkohshme për ta lehtësuar efektin e pandemisë "COVID-19".

III. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 8, 12, 16 dhe 29 tetor 2020:

1. Votimi në parim i Projektligjit nr. 07/L-018 për ndryshim plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete,
2. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca me kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetes Besa Ismaili-Ahmeti, mbështetur edhe nga 8 deputetë të GP të PDK-së, në lidhje me përgjegjësitë në raport me zhvillimet në procesin e dialogut në Bruksel lidhur me punën e grupeve teknike.

IV. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 21 dhe 29 tetor 2020:

1. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca me kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetes Fitore Pacolli-Dalipi, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LVV-së, në lidhje me pezullimin njëvjeçar i aplikimit të Republikës së Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare,
2. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca me kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetes Mimoza Kusari-Lila, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LVV-së, në lidhje me përfshirjen e Republikës së Kosovës në "Zonën e mini-Shengenit ballkanik",
3. Votimi i propozim-rezolutës nga interpelanca me kryeministrin të Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetit Rexhep Selimi, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LVV-së, në lidhje me deklarin dhe qëndrimin e Kryeministrit për zbatimin e Marrëveshjes për themelimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe.

V. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 29 tetor, 2 dhe 3 nëntor 2020:

6. Votimi në parim i Projektligjit nr. 07/L-021 për të drejtat pronësore të shtetaseve të huaj në Republikën e Kosovës,
8. Votimi i propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me problemet e banorëve shqiptarë në veri të Mitrovicës dhe komunave të tjera në pjesën veriore të Kosovës lidhur me pengesat që u bëhen për tu kthyer në pronat e tyre dhe pengesat për renovimin e shtëpive të djegura gjatë luftës,
9. Kërkesa e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me procesin e licencimit, operimit, mbikëqyrjes dhe aplikimit për lejet e hidrocentraleve në Republikën e Kosovës për miratimin e buxhetit të këtij Komisioni Hetimor,
10. Votimi i rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin vjetor të Auditimit për vitin 2019,
11. Votimi i propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me vazhdimin e Qeverisë së Serbisë që të mbaj të fshehur të vërtetën për fatin e mbi 1600 civilëve shqiptarë, të rrëmbyer nga ky shtet gjatë luftës gjenocidale në Kosovë, që ende konsiderohen të zhdukur,
12. Votimi i propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me sensibilizimin dhe masat që duhet të ndërmerren nga Qeveria dhe institucionet përgjegjëse në luftën kundër kancerit të gjrit.

3. Përgatitjet për seancë të re plenare

Kryesia, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi i Republikës së Kosovës, të enjten, më 12 nëntor 2020, në orën 10:00 të mbajë seancë të re plenare, me këtë:

Rend dite

1. *Deklarimet jashtë rendit të ditës,*
2. *Pyetjet parlamentare,*
3. *Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovë, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetit Liburn Aliu, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LVV-së, për çështjen “Përfshirja dhe ndarja e liqenit të Ujmanit me Serbinë në dokumentin e zotimeve të 4 shtatorit 2020”,*
4. *Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovë, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetes Saranda Bogujevci, mbështetur edhe nga 6 deputetë të GP të LVV-së, për çështjen “Trajtimi i dëmshëm i temës së të pagjeturve në zotimet e 4 shtatorit, duke e kushtëzuar me personat e zhvendosur”,*
5. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 07/L-033 për të drejtën ndërkombëtare private,*
6. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 07/L-027 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social,*
7. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 07/L-028 për Inspektoratin e Punës,*

8. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 07/L-038 për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara në transaksionet elektronike,*
9. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 07/L-012 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256,*
10. *Shqyrtimi i raportit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2019,*
11. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2019,*
12. *Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për raportin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin 2019,*
13. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik për vitin 2019,*
14. *Shqyrtimi i raportit vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2019,*
15. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2019,*
16. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komunitetit shqiptar.*

* * *

Kryesia, po ashtu në lidhje me pikën 16 të lartshënuar të rendit të ditë për seancën e re plenare, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohe nga grupet parlamentare të Kuvendit që para se të mbahet seanca plenare më 12. 11. 2020, t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar të parë dhe të dytë, si dhe për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave nga radhët e komunitetit shqiptar.
2. Përbërja e Komisionit ad hoc do të jetë, si në vijim: GP i LVV-së 3 anëtarë (nënkryetarin e parë dhe 2 anëtarë); GP i LDK-së 2 anëtarë; GP i PDK-së 2 anëtarë; GP i AAK-së 1 anëtar; GP i Listës serbe kryetarin; GP-NISMA-AKR 1 anëtar dhe GP "6+" nënkryetarin e dytë.

* * *

Kryetarja i njoftoi të pranishmit se në lidhje me pikën 4 të lartshënuar të rendit të ditë për seancën e re plenare, Shoqata "Thirrjet e Nënave" ka kërkuar që t'u jepet mundësia që përfaqësueset e asaj shoqate t'i adresohen Kuvendit në seancën plenare lidhur me çështjen e të pagjeturve.

Pastaj, ajo kërkoi nga të pranishmit të deklarohen në lidhje me këtë çështje, për mënyrën dhe mundësitë që përfaqësues të organizatave joqeveritare që përfaqësojnë familjet e të pagjeturve t'i adresohen Kuvendit për çështjen e të pagjeturve.

Diskutimi i plotë i kryetares është dhënë në transkript.

Në lidhje me çështjen e lartshënuar, diskutuan: nënkryetarja e Kuvendit, Arbërie Nagavci; Arben Gashi, në emër të GP të LDK-së; Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së dhe nënkryetari i Kuvendit, Memli Krasniqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se pasi Administrata e Kuvendit ta përgatisë një listë të organizatave joqeveritare që përfaqësojnë familjet e të pagjeturve, Kryesia e Kuvendit do të vendosë për mundësimin e përfaqësuesve të atyre organizatave që t'i adresohen Kuvendit në lidhje me çështjen e të pagjeturve.

Diskutimi i plotë i kryetares është i dhënë në transkript.

* * *

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe i kërkesave

1. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovë, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetit Rexhep Selimi, mbështetur edhe nga 7 deputetë të GP të LVV-së, në lidhje me shfuqizimin e Task-forcës antikorrupsion në Policinë e Kosovës

Në lidhje me interpelancën e lartshënuar, Kryesia, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi i Republikës së Kosovës, të premtën, më 13 nëntor 2020, në orën 15:00 të mbajë seancë plenare, me këtë:

Rend dite

1. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovë, z. Avdullah Hoti, sipas kërkesës së deputetit Rexhep Selimi, mbështetur edhe nga 7 deputetë të GP të LVV-së, në lidhje me shfuqizimin e Task-forcës antikorrupsion në Policinë e Kosovës.

2. Shqyrtimi i kërkesës së nënkryetares së Kuvendit, znj. Arbërie Nagavci, për thirrje në raportim të ministrit të Shëndetësisë, Armend Zemaj, lidhur me situatën pandemike

Kryetarja i njoftoi të pranishmit se nënkryetarja e Kuvendit, Arbërie Nagavci, ka kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që ta thërrasë në raportim Ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj, lidhur me situatën pandemike.

Pastaj, nënkryetarja e Kuvendit, Arbërie Nagavci, e paraqiti dhe e arsyetoi kërkesën e lartshënuar, diskutimi i së cilës është dhënë në transkript.

Në lidhje me kërkesën e lartshënuar, diskutuan: Arben Gashi, në emër të GP të LDK-së; kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani-Sadriu dhe Memli Krasniqi e Arbërie Nagavci, nënkryetarë të Kuvendit, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se kërkesa për thirrje në raportim të ministrit të Shëndetësisë, Armend Zemaj, lidhur me situatën pandemike, duhet të formalizohet me të paktën 6 nënshkrime të deputetëve të Kuvendit.

Pastaj, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, Kryesia me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare vendosi që Kuvendi i Republikës së Kosovës, të martën, më 17 nëntor 2020, në orën 13:00 të mbajë seancë plenare, me këtë:

Rend dite

1. Debat parlamentar në lidhje me gjendjen pandemike në vend dhe menaxhimin e situatës me pandeminë COVID-19 në Republikën e Kosovës nga ana Qeverisë.

3. Nisma legislative “Projektligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave”

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e nismës legislative të lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me Nismën legislative: Projektligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

4. Kërkesa e ministres së Financa, Hykmete Bajrami, në lidhje me përmbylljen e vitit fiskal 2020

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Qeverisë së Republikës së Kosovës i kthehen mjetet buxhetore të kursyera nga të gjitha kategoritë e shpenzimeve të buxhetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në shumë prej 1,058,000.00 €.

5. Nisma legislative “Projektligji për Fshatin Kabash”

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e nismës legislative të lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me Nismën legislative: Projektligji për Fshatin Kabash, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

6. Nisma legislative “Projektligji për ndryshim plotësimin e Ligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti”

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e nismës legislative të lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me Nismën legislative: Projektligji për ndryshim plotësimin e Ligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afatin prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

7. Shqyrtimi i kërkesës së kryetares së Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë, znj. Time Kadrijaj, për lejimin e kompensimit të shpenzimeve në lidhje me realizimin e udhëtimit zyrtar në Hungari

Kryetarja, në lidhje me kërkesën e lartshënuar, kërkoi nga Administrata e Kuvendit që ta përgatisë një arsyetim për mungesën e bazës ligjore për miratimin e kërkesës së znj. Kadrijaj, sepse edhe nga praktikatat e mëparshme shpenzimet për udhëtimet zyrtare të deputetëve me ftesë të Qeverisë, përkatësisht të ministrive janë mbuluar nga Qeveria, përkatësisht ministria përkatëse.

Diskutimi i plotë i kryetares është dhënë në transkript.

8. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë për mbulimin e shpenzimeve nga vizita zyrtare në Tiranë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Anëtarëve të Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë: Time Kadrijaj, Fatmire Kollçaku, Ariana Musliu-Shoshi dhe Fidan Brina Jilta u lejohet kompensimi i të gjitha shpenzimeve edhe për një ditë shtesë, në lidhje me realizimin e udhëtimit zyrtar në Tiranë (Shqipëri) nga 20 - 22 tetor 2020, sipas kërkesës së bashkangjitur me nr. 07/979/Do-586, datë 26. 10. 2020.

9. Konfirmimi i formimit të delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Komisionin e Përbashkët Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE - Kosovë

Kryesia, pas konstituimit të Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Komisionin e Përbashkët Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë, mori këtë:

V E N D I M

I. Konfirmohet formimi i Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës në Komisionin e Përbashkët Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë, prej 13 anëtarëve, si në vijim:

1. Arben Gashi, kryetar, dhe Kujtim Shala, zëvendës - nga GP i LDK-së.
2. Fitore Pacolli-Dalipi, nënkryetare, dhe Dimal Basha, zëvendës - nga GP i LVV-së.
3. Mimoza Kusari-Lila, anëtare, dhe Elbert Krasniqi, zëvendës, nga GP i LVV-së.

4. Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, anëtare, dhe Gazmend Gjyshinca, zëvendës - nga GP i LVV-së.
5. Frashër Demaj, anëtar, dhe Saranda Musliu, zëvendëse - nga GP i LDK-së.
6. Ilir Tasholli, anëtar, dhe Besa Gaxherri, zëvendëse - nga GP i LDK-së.
7. Enver Hoxhaj, anëtar, dhe Abelard Tahiri, zëvendës - nga GP i PDK-së.
8. Blerta Deliu-Kodra, anëtare, dhe Valdete Idrizi, zëvendëse - nga GP i PDK-së.
9. Ariana Musliu-Shoshi, anëtare, dhe Eliza Hoxha, zëvendëse - nga GP i PDK-së.
10. Ali Berisha, anëtar, dhe Arber Tolaj, zëvendës - nga GP i AAK-së.
11. Branislav Nikoliq, anëtar, dhe Igor Simiq, zëvendës - nga GP i Listës serbe.
12. Endrit Shala, anëtar, dhe Veton Berisha, zëvendës - nga GP-NISMA-AKR.
13. Albert Kinolli, anëtar, dhe Fidan Brina Jilta, zëvendëse - nga GP "6+".

10. Kërkesa e Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për procedim në seancë plenare të propozimit të këtij Komisioni për plotësimin e Vendimit për themelimin e komisioneve parlamentare

Kryesia, pasi diskutoi përsëri në lidhje me propozimet e disa komisioneve parlamentare për ndryshimin e emërimit dhe fushëveprimtarive të tyre, nxori këtë:

A U T O R I Z I M

Autorizohen nënkryetarët e Kuvendit: Arbërie Nagavci dhe Kujtim Shala, që në bashkëpunim me Administratën e Kuvendit të konsultohen me kryetarët e komisioneve parlamentare: Komisioni për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike dhe ai për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Infrastrukturë dhe Mjedis, që t'i harmonizojnë emërimet dhe fushëveprimtaritë e tyre, që mbi bazën e Vendimit të Kuvendit për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, datë 3 qershor 2020, t'ia paraqesin Kryesisë së Kuvendit propozimet për harmonizimin e emërtimeve dhe fushëveprimeve të komisioneve, të cilat më pas do të procedohen për miratim në seancë plenare.

11. Informatë e Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë për vizitën zyrtare të realizuar në Republikën e Shqipërisë

Kryesia u njoftua me shkrim nga Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë për vizitën zyrtare të realizuar në Republikën e Shqipërisë, nga 20 - 22 tetor 2020.

Kryetarja e Kuvendit e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 15:05 minuta.

Vjosa Osmani - SADRIU

Kryetare e Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale